



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1065/2 Prot.

Tiranë, më 30.07.2021

V E N D I M

Nr. 112, datë 30.07.2021

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRPRERJES SË MARRËDHËNIES SË  
PUNËS ME UST-NË, TË PEDAGOGUT FERDINAND CANAJ DHE ZBATIMIT  
TË DETYRIMEVE LIGJORE QË RRJEDHIN PREJ SAJ**

Në zbatim të Kodit të Punës së RSH, të pikës 5 të nenit 39, pikës 2 të nenit 68 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, neneve 23, 60, 61 ( pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9) të Statutit të UST-së, nenit 38, pika 1, gërma “d”, nenit 39 të Rregullores së UST-së, si dhe në vazhdimësi të Vendimit nr. 1 të datës 18.01.2021 “Mbi shqyrtimin e “Kërkesës ankimore” të paraqitur nga Prof. Dr. Agron Kasa më datë 26.10.2020” të Këshillit të Etikës si dhe Relacionit bashkangjitur këtij Vendimi, Vendimit nr. 1 datë 06.05.2021, me nr. 693 prot. “Për zgjidhjen e kontratës së punës me anëtarin e personelit akademik” dhe relacionit bashkëngjitur, paraqitur Senatit Akademik të UST-së në mbledhjen e datës 07.05.2021, Senati Akdamik ne mbledhjen e tij të datës 30.07.2021

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Universitetin e Sporteve të Tiranës, për personelin akademik, pedagogun Ferdinand Canaj me motivacionin:

***“Për kryerjen e veprimeve flagrante dhe haptazi në kundërshtim me etikën dhe rregullat e funksionimit të institucionit publik të arsimit të lartë, Universitetit të Sporteve të Tiranës”***

2. Ky Vendim i përcillet Rektorit të UST-së për të vazhduar procedurën.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1065 Prot.  
12

Tiranë, më 30.07.2021

V E N D I M

Nr. 112, datë 30.07.2021

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRPRERJES SË MARRËDHËNIES SË  
PUNËS ME UST-NË, TË PEDAGOGUT FERDINAND CANAJ DHE ZBATIMIT  
TË DETYRIMEVE LIGJORE QË RRJEDHIN PREJ SAJ**

Në zbatim të Kodit të Punës së RSH, të pikës 5 të nenit 39, pikës 2 të nenit 68 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, neneve 23, 60, 61 ( pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9) të Statutit të UST-së, nenit 38, pika 1, gërma “d”, nenit 39 të Rregullores së UST-së, si dhe në vazhdimësi të Vendimit nr. 1 të datës 18.01.2021 “Mbi shqyrtimin e “Kërkesës ankimore” të paraqitur nga Prof. Dr. Agron Kasa më datë 26.10.2020” të Këshillit të Etikës si dhe Relacionit bashkangjitur këtij Vendimi, Vendimit nr. 1 datë 06.05.2021, me nr. 693 prot. “Për zgjidhjen e kontratës së punës me anëtarin e personelit akademik” dhe relacionit bashkëngjitur, paraqitur Senatit Akademik të UST-së në mbledhjen e datës 07.05.2021, Senati Akdamik ne mbledhjen e tij të datës 30.07.2021

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Universitetin e Sporteve të Tiranës, për personelin akademik, pedagogun Ferdinand Canaj me motivacionin:

***“Për kryerjen e veprimeve flagrante dhe haptazi në kundërshtim me etikën dhe rregullat e funksionimit të institucionit publik të arsimit të lartë, Universitetit të Sporteve të Tiranës”***

2. Ky Vendim i përcillet Rektorit të UST-së për të vazhduar procedurën.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**PROF.DR. AGRON KASA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

**PROCES – VERBAL I MBLEDHJES SË SENATIT AKADEMIK TË UST TË DATËS  
30.07.2021**

**A.Kasa:** Çështja e parë për sot lidhet me ndryshimet në Statut, ndryshime të cilat nuk i bënim dot para procesit të akreditimit. Ky Statut i ri është përshtatur me rregulloret e miratuara rishtazi.

Rektorati ka diskutuar çdo nen të Statutit në një mbledhje të zgjeruar të tij. Çdo sugjerim i dhënë dhe që është parë i arsyeshëm për t'u shtuar, është shtuar, dhe kemi ardhur në këtë version final që ju kemi dërguar edhe juve në e-mail.

Çdo fjali e shënuar me të kuqe është një ndryshim i bërë në raport me Statutin aktual.

\*Neni 14 është menduar të hiqet fare. Neni 14 lidhej me departamentet e krijuara nga njësi kryesore të ndryshme por duke qenë se nuk gjen zbatim në rastin e Universitetit tonë kemi menduar ta heqim për të mos e rënduar më shumë.

**A.Cuka:** Neni 19, pika 3, thotë që drejtuesit e njësive kryesore janë pjesë përbërëse e Senatit. Është diskutuar edhe më parë dhe duke qenë se konsiderohet opozitë e Senatit, u vendos që të mos ishin pjesë.

**A.Kasa:** Së pari kurrsesi Rektorati nuk mund të konsiderohet në opozitë me Senatin. Puna fillon në Rektorat dhe të gjitha propozimet vijnë më pas në Senat, ato që i takojnë Senatit. Dekani është personi më i votuar nga njësia kryesore ndaj nuk bën sens që të mos e përfaqësojë njësinë e tij në Senatin Akademik.

**F.Gjata:** Ideja e vendosjes apriori së drejtuesit të njësisë kryesore në Senat humbet të drejtën zgjedhore. Le të jetë pjesë e Senatit nëse zgjidhet por jo apriori. Është ndryshe nga rasti i Rektorit që është automatikisht Kryetar i Senatit.

**A.Kasa:** Anëtari i Senatit Akademik është një autoritet dhe Ligji i Arsimit të Lartë përcakton qartë se cilët janë autoritet në IAL: Rektori, Administratori, Dekanët/Drejtuesit e njësive kryesore. Është në të mirë të institucionit që Dekani/Drejtuesi i njësisë kryesore të jetë edhe anëtar i Senatit Akademik. Ndaj asambleja e njësisë kryesore ta ketë të qartë se kur voton drejtuesin e njësisë së vet, ka zgjedhur automatikisht edhe përfaqësuesin e saj në Senat.

Dekani atë që ja njeh ligji duhet t'ja njohim edhe ne.

\*Senati i ri që do të vijë do të ketë 15 anëtarë dhe jo më 13: Rektori, drejtuesit e njësive kryesore, 2 përfaqësues nga çdo njësi kryesore dhe 2 përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli Studentor.

\*Tek komisionet e përhershme janë cituar emërtimet e të gjitha komisioneve të ngritura në UST. Është shtuar gjithashtu pika që një person (personel akademik apo student) mund të jetë pjesë e jo më shumë se dy komisioneve të përhershme.

**Dh.Bozo:** Neni 39 pika b. Mendoj të hiqet fjala mbledhje, të thuhet që drejton shpërndarjen e ngarkesës.

**A.Kasa:** Në nenin 43 është shtuar pika “rr” që lidhet me shpërblimet në mënyrë që çdokush që punon të shpërblehet për atë që bën, edhe të kemi një bazë ligjore ku t’i mbështesim këto shpërblime.

**Dh.Bozo:** Neni 96, pika 2. Aty ku thuhet të çdo fakulteti, të thuhet të çdo njësie kryesore, që të jetë njësoj me pikën 1.

Neni 97, pika 3. Këshilli Studentor ka akses të garantuar në faqen zyrtare të internetit të UST në një rubrikë të dedikuar, të menaxhuar prej tyre konform një rregulloreje të miratuar.

**A.Kasa:** Ky pra është Statuti i ndryshuar dhe i përmirësuar.

- **Kalojmë në votimin për miratimin e ndryshimeve në Statut.**

### MIRATOHET

**A.Kasa:** Ju bëj me dije se kam një takim me Ministren, bashkë me Administratoren e UST, në lidhje me çështjen e pronave të këtij Universiteti. Çështja është mjaft e koklavitur por do të punojmë fort në bashkëpunim edhe me Qeverinë dhe shpresojmë të zgjidhim sa më shpejt këtë problem.

\*Në lidhje me çështjen tjetër për PBA për vitet 2022-2024. Është e nevojshme për ju për sqarime nga Administratorja?

**R. Citozi:** Kemi qenë pjesë e procesit, jemi pjesë e atyre që kanë dhënë propozimet, ndaj jemi dakort.

- **Kalojmë në votim për miratimin e propozimeve për PBA për vitet 2022-2024.**

### MIRATOHET

**A.Kasa:** Çështja 3 lidhet me tarifat e regjistrimit për konkurs, regjistrimit të fituesve dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2021-2022. Tarifat janë të njëjta si një vit më parë.

- **Kalojmë në votim për miratimin e tarifave.**

### MIRATOHET

**A.Kasa:** Çështja tjetër lidhet me fillimin e procedurave për shpërndarjen e marrëdhënies së punës me personelin akademik, Z. Ferdinand Canaj. Çështja ka kaluar në Këshillin e Etikës së UST, pas Vendimit të tyre në Senat është ngritur një Komision Ad-Hoc, i cili është shprehur me një Vendim. Vendimi Nr. 1 i këtij Komisioni,

shoqëruar edhe me relacionin përkatës, është Vendimi me të cilin jeni njohur edhe ju nëpërmjet e-mailit. Sot e kam sjellë në këtë mbledhje në mënyrë që ai Vendim të marrë edhe miratimin tuaj, kështu propozoj miratimin e efekteve financiare në përputhje me Kodin e Punës për zgjidhje kontrate.

- **Kalojmë në votim për miratimin e vendimit për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me anëtarin e personelit akademik, Z. Ferdinand Canaj.**

## MIRATOHET

**A.Cuka:** Unë personalisht jam kundër votimit sepse mendoj se nuk është kompetencë e imja, si anëtar Senati. Është ngritur një Komision Ad-Hoc i cili ka dhënë mendimin e tij nëpërmjet një Vendimi, shoqëruar edhe me një relacion. Unë respektoj Vendimin e tyre por refuzoj të votoj sepse siç thashë nuk mendoj se është detyrë e imja si anëtar i këtij Senati.

**A.Kasa:** Atëherë do më duhet që të më paraqisni argumentin tuaj me shkrim nëpërmjet protokollit, ku të shprehni të gjithë arsyet tuaja se pse e refuzoni këtë proces.

### Morën pjesë:

A. KASA

A. KAÇURRI

DH. BOZO

F. GJATA

J. JARANI

A. CUKA

A. META

R. ÇITOZI

F. MARA

E. SPAHIU

B. DELIA

XH. CULLHAJ

**Mbajti Proces – Verbalin**  
Xhovana LOZI

